



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

VENDIM

Nr. 138 , Datë 25 / 11 / 2021

**Për miratimin e vazhimit të procedurave të heqjes nga fondi pyjor për sipërfaqen pyjore e cila do t'u nënshtrohet procedurave të heqjes nga fondi pyjor.**

Bazuar në Ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 8480 datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Ligjin nr. 107/2014 datë 31.7.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, në Ligjin nr. 57/20, datë 30.04.2020 “Për Pyjet”, në Ligjin nr. 10 304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 433 datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike...” të ndryshuar, në VKM nr. 591, datë 09.10.2018 Për disa ndryshime në Vendimin nr 1353, datë 10.10.2008, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe të kriterëve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e vëllimit të fondit pyjor” të ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr. 1, datë 9.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik”.

VENDOSI

1. Të shprehë miratimin për vazhdimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor, me vendim të Këshillit Bashkiak për sipërfaqen pyjore prej 38.8 ha të ndodhur në ekonominë pyjore Zëmlak-Qarr, në ngastrat nr. 155b, 156, 158a, 159 dhe 160a, e cila do t'u nënshtrohet procedurave të heqjes nga fondi pyjor.
2. Për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Bujqësisë dhe Pyjeve.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

KRYETARI

Erjon NEXHIPI